



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 28 korrik 2021, në mbledhjen e XXXIX-të (tridhjetë e nëntë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;15

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSSH.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar dhe përshëndetur të pranishmit, theksoi, nëse ka dikush diçka për të shtuar urdhëroni, nëse nuk ka diçka për të shtuar e vë në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje.

Njëzëri miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 25 qershor 2021

Njëzëri pa plotësim ndryshime miratohet procesverbali i KPF-së i datës 25 qershor 2021.

z.Mehmet Gashi, theksoi, para se të fillojmë me punë sipas pikave të rendit të ditës, në mbledhjen e kaluar, gjatës diskutimeve për raporti financiar, është ngritur dhe është shtruar pyetje edhe nga shefi i Grupit të LDK-së gjatë asaj mbledhje dhe jemi dal me një qëndrim ngase nga Drejtori i DBF gjatë diskutimit jemi ofenduar, dhe atë goxha shumë sa që ndier rëndë të prekur ndaj fjalorit që ka përdorur ndaj këshilltarit të LDK-së. T'ju them të drejtën, unë i kam bërë këto vite dhe ende nuk ka mundur askush të thotë se jam i pa moralshëm, unë në jetën time asnjëherë as në Gjykatë e as në organe të drejtësisë nuk kam pasur diçka, prandaj ajo fjalë që është thënë në atë mbledhje, e konsiderojmë si goxha të rëndë ta "kapërdijmë", kështu që ka qenë mirë që drejtori i DBF, para se ta marr fjalën sot këtu, të distancohet prej atij fjalori sepse përndryshe nuk e di ne Kuvend si do të veprojmë gjatë raportimit të drejtorit të DBF.

Jo vetëm unë, por tek të gjithë anëtarët e Grupit të LDK-së nëse në ndonjë pikë ka vërejtje që kemi shkelur diçka tek morali, atëherë konsiderojmë se paska argumente, kështu që unë me atë fjalë personalisht jam prekur, me sa vite përvojë pune nuk ka ardhur ndokush të më thotë gjëra të tilla, madje personalisht as nuk kam veturë, as nuk kam shtëpi përveç prindërit që më kanë lënë, as asgjë në këtë kontekst dhe nuk ka ndonjë fakt, por nuk e di se nga e mori atë fjalë drejtori i DBF-së, nuk di ndoshta ashtu i ka rrëshqitur sepse ndoshta ndonjëherë njeriu edhe gabon. Vetëm se ta them të drejtën mirë ka qenë drejtori i DBF ta sqaroi se çfarë mendon me atë fjalë, e përsërisë sepse ne jemi të prekur dhe nuk e di se çfarë qëndrimi do të marrim në Kuvend në si Grup i këshilltarëve. Përndryshe unë kam respekt për babain e drejtorit në fjalë dhe ka qenë profesor, madje për ata që punojnë në financa e kanë një lloj përparësie tek unë sepse kam punuar edhe vet, mirëpo atë ditë ka qenë kështu, është procesverbali, është incizimi i asaj seance, kështu që për këtë mbledhje nuk jam për të penguar, por në Kuvend mund të shikojmë, bisedojmë për më tutje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, për qëndrimin e Grupit të këshilltarëve të LDK-së në mbledhjen e kaluar që ka qenë sigurisht që drejtori i DBF është i informuar.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF-së, theksoi, në kohën kur e ka paraqitur qëndrimin shefi i Grupit të asamblistëve të LDK-së, në qoftë se nuk gaboj unë kam qenë i pranishëm, mirëpo pastaj është shikuar në aspektin individual dhe është marrë një qëndrim për këtë çështje dhe është quajtur ofendim nga asamblistët e LDK-së. Absolutisht unë nuk kam bërë ofendim, unë kam pasur debat me X personin i cili në mënyrë të vazhdueshme ofendon, dhe tani unë bije nga pozicioni që t'i respektoj çdonjërin dhe për këtë jeni shumë të vetëdijshëm edhe ju se sa i respektoj njerëzit edhe unë, besoj që është edhe reciprok, por ofendim në asnjë mënyrë, në qoftë se quhet ofendim atëherë edhe unë ndihem i ofenduar sepse nuk kam ofenduar as tani as asnjëherë dhe nuk ka qenë debati që unë e kam quajtur ndokënd me fjalën të pa moralshme ndaj grupit të asamblistëve ose ndaj tërë asamblistëve, unë e kam pasur programin, jam përgjigjur për komplet specifikat që i kanë miratuar me KAB ku pjesë e kritikave keni qenë edhe ju, mirëpo juve ju kam përgjigj në mënyrën më korrekte të mundshme, normalisht ju i keni jap kritikën unë i kam jap qëndrimet e mia të cilat duhet për të paraqitur KAB, në fund votoni për ose kundër, përkundër që interesi kishte qenë të votohet për, por sido që të jetë ajo është çështje e qëndrimit politik që nuk mundemi të interferojmë asnjëri në tjetrin, mirëpo personi, asamblisti konkretisht z.Adnan Zymeri me atë referat lexon 40 minuta dhe ofendon me shprehjet, praktikant të pa dijshtëm, tani për një mend me fjalën të padijshëm nuk ia vlen asnjë profesori nëse të quan sepse ai është përnjëmend ofendim, e lëre më z.Adnan Zymeri, prandaj nuk ja lejoj askujt atë.

Në qoftë se nuk e merr parasysh ndokush kulturën timen ose të dikujt tjetër, por për qyqar nuk ndodh ajo çështje, prandaj kjo është e pa vërtetë që unë i kam quajtur të pa moralshëm, absolutisht për ju z.Mehmet Gashi kam shumë respekt dhe nuk kam thënë asnjë fjalë të keqe për ju, as nuk ju kam quajtur të pa moralshëm, kurse tani kjo nuk e di ndoshta është përpjekje për me ngritë para zgjedhjeve, por unë nuk kam nxitë asgjë, vetëm ju kam referuar X personit, madje as atij nuk i kam thënë i pa moralshëm, vetëm kam thënë ti për moral mos fol, dhe ia kam përmend rastin që njëmend ndoshta nuk është i duhuri si një debat në asamblenë komunale në Kuvend, por ai i përmend rastet që ia shkruan dikush tjetër dhe vije këtu të quan se e kanë marrë prej niveli qendror të cilin ia shkruan dikujt tjetër dhe vije këtu dhe thotë se ka marrë LVV-ja praktikantë, me çfarë ekspertize thuhet kjo, mirëpo shprehjen të pa moralshëm, për grupin e asamblistëve të LDK-së apo ndonjë grup tjetër nuk e kam përdorur.

Arsyeja që e ka jap z.Hasan Ajeti që e ka thënë se do ta bojkotojmë punën në Kuvendin e Komunës, ka qenë që kur e kam quajtur çështjen e kulturës se i kemi jap prioritet kulturës edhe niveli qendror edhe niveli lokal për arsye se ndoshta nëse në pushtet kam thënë që janë disa njerëz më të kulturuar, por çështje të kulturës nuk ka të bëjë me çfarë niveli ka ra, shembull për çështje të kulturës mundet me qenë një njeri që ka shije më të madhe për kulturën, për letërsinë për teatrin për galerinë, e kam thënë në këtë kontekst por jo ashtu, “njerëz të pa kulturuar”, në qoftë se i japim prioritet shumë më shumë kulturës, në rregull

mundemi me thënë që ne e kemi prioritet më shumë këtë çështje, jemi më të kulturuar, mirëpo as kjo nuk ka pasur asnjë qëllim ofendimi, por edhe përkundër kësaj në rast se ndokush ndihet i ofenduar me atë që unë e kamë thënë, sinqerisht më vije keq, nuk ka pasur për qëllim ofendimin as nuk kam ofenduar, aq më pak për qëllim ofendimi, dhe po them sërish që debati në këtë çështje ka qenë për KAB, çështje të cilën akuzën të cilën është ngritur, ofendime, dije e pa dije nga z.Adnan Zymeri, sigurisht që ja kam kthyer dhe ia kthej sërish, prandaj edhe njëherë po e përsërisë që kulturën time të mos e mendon askush si qyqarllëk, sepse dallon kjo çështje.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, vetëm për hir të korrektësisë, ne siç e tha edhe kolegu z.Mehmet Gashi por edhe të gjithë besoj që kemi pasur një qasje shumë korrekte ndaj drejtorit të DBF-së, madje madje edhe në disa raste një qasje goxha miqësore edhe ne që nuk jemi njohur më parë, por dua ta sqaroj edhe personalisht por edhe në emër të Grupit që ne nuk interferojmë ose të paktë unë si Fatlume nuk interferoj në pika që pritet t'i bëni veçmas me asamblistë, dhe nuk mbaj përgjegjësi as për fjalët që mund t'i thotë një koleg i grupit tim, por as për grupet tjera e aq më pak për drejtorët e Ekzekutivit. Për ta sqaruar një herë e mirë, ne çfarë kemi kërkuar si grup është që fjala që ju e keni thënë që tani ka njerëz më të edukuar ose kulturuar se sa kanë qenë, dhe keni folur edhe për disa projekte që janë realizuar në të kaluarën dhe që realizohen tani, këtu mund të ketë pasur persona të ndershëm që kanë punuar çoftë në Ekzekutiv çoftë në Kuvend nga radhët e LDK-së që mund të jenë ndjerë të ofenduar nga kjo deklaratë e juaja, pra kjo ka qenë çështja, jo për replikat që ju mund t'i bëni me persona, dhe ajo çfarë ne kemi kërkuar është që ju drejtor të kërkonit falje publike sepse ju duhet të mbani përgjegjësi nëse mendoni që dikush është ofenduar nga ajo deklaratë e juaja, përndryshe e kemi thënë që ne nuk do të qëndrojmë në sallë në kohën kur ju do të keni ndonjë pikë që do t'i adresoheni. Pra vetëm deshta ta sqaroj që ky është qëndrimi i LDK-së, mund të ketë pasur persona që kanë punuar më herët, qoftë në drejtori të caktuara dhe në vende tjera, dhe kur ju thoni që jeni më të kulturuar, mund ta ndjenjë vetën të ofenduar secili.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF-së, theksoi, e thashë edhe më herët sepse po i bije ta përsërisë, absolutisht qëllim ofendimi nuk kam pasur, nuk ofendoj tash e 35 vite, në çoftë se ndokush është ndjerë i ofenduar ndaj asaj që kamë thënë, sinqerisht më vije keq dhe kërkoj falje në rast se është ndjerë, por nuk kam ofenduar, kjo është çështja, mirëpo të mos merret kështu kjo çështje, në çoftë se ndokush një fjalë e thotë që nuk e pëlqen, sepse ai (Adnan Zymeri) ka ofenduar tërë kohën, do të thotë një referat të tërë 15 minuta e ka lexuar dhe qëllimi nga pika në pikë ka qenë ofendimi ndaj qeverisjes të një subjekti politik duke i quajtur praktikantë, unë nuk po them që ai e ka thënë, por po e them se ai ka ofenduar dhe unë iu kam përgjigjur, madje mendoj se ju kam përgjigjur thuajse më but, dhe e kam cekur rastin që unë mendoj që për atë mbaj çfarëdo përgjegjësie nga organi gjyqësor, për atë gjë kam dëshmitar, ai e ka thënë dhe e ka përmend atë çështje, kurse unë vetëm ia përmenda aty, dhe i kam thënë mos më shit moral këtu se kështu është çështja, por sinqerisht në rast se ndiheni të ofenduar ju kërkoj falje, mirëpo qëllimi absolutisht nuk ka qenë ofendimi, dhe nuk kam ofenduar, por nganjëherë njeriu e thotë një fjalë që dikush mundet me u ndjerë keq, në çoftë se është ndjerë keq ndokush mua sinqerisht më vije keq në rast se jeni ndjerë të ofenduar.

z.Mehmet Gashi, theksoi, të mos kuptohet kjo nga drejtori i DBF-së si diçka që duam ta bëjmë politike këtë gjë, nuk ka diçka prej kësaj që ne duam të përfitojmë, por për atë diskutim është procesverbalë dhe e kemi dëgjuar të gjithë, nëse ju atë që po e thoni se kërkon falje për atë lllpasuz që ke bërë, në rregull është nuk e ke pasur me qëllim të na ofendosh, mirëpo mos e merr që po duam të bëjmë kurrfarë politike.

Me të vërtetë e kam pasur një respekt shumë, por po ashtu vërtetë e kam ndjerë vetën keq sepse edhe unë jam pjesë e LDK-së, dhe të thuhet ju LDK-së jeni ashtu, kurse ne jemi në rregull. Po të ishte konkret vetëm me personin e cekur do të ishte ndryshe edhe pse nuk është mirë për askënd.

Unë kurrë në jetën time nuk besoj që kam ofenduar ndokënd, ju të tjerët më njihni edhe më herët, z.Avni Fetahu ka punuar me mua, unë mundohem ta ruaj secilin dhe nëse e marr fjalën e kam opinionin tim,

shembull kam disa vërejtje, aty çdo kush e dinë, mirëpo tek kjo çështje ka qenë kështu, mirëpo nuk po dua më tepër të bëjë këtë debat.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF-së, theksoi, unë po them që përfundoj pak a shumë si debat kjo çështje, unë e tregova qëllimin, mirëpo në rast se lëshohemi se kush kënd ka rënduar, ne jemi quajtur këtu nga X asamblisti “Brigada të kuqe” ky është më ofendim sesa t’ju quan dikush se ke një mungesë dhe nuk i ke jap prioritet kulturës, pra në qoftë se them se nuk i ke jap prioritet kulturës kurse ne i kushtojmë më rëndësi kulturës, dhe mundesh me u ndje i ofenduar gjë për të cilën më vije keq, por të dalësh të flasësh publikisht me shprehjet “Brigadat e kuqe” e që ato kanë qenë të Rusisë, çka mendoni ju, unë jam i Ballocit, prandaj mua më paskeni dëgjuar, kurse atë nuk e keni dëgjuar, a është ofendim ajo.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, para se të fillojmë me pikën e parë, pra u pa edhe nga debati se ne dëshirojmë që ju të kërkonit falje drejtor dhe rastet e tilla të mos përsëriten nga askush sepse është edhe obligim ligjor edhe i imi personalisht që ofendimet dhe çështjet tjera nuk duhet t’i lejojmë dhe pastaj duhet të vijmë në një situatë ku duhet të ndërprehet edhe liria e fjalës dhe ajo e demokracisë, prandaj mos keqpërdorni ju lutem, as ju si Ekzekutiv, as këshilltarët por t’i përmbaheni rendit dhe rregullores. E kam parasysh se nganjëherë veprimet me emocione, dalim nga vetvetja por mos të hyjmë në ofendime që nuk tolerohen.

2. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Podujevës për vitin 2020

- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF-së, theksoi, lidhur me raportin e Auditimit i cili është për pasqyrat financiare ligjore të Komunës së Podujevës për vitin 2020, besoj që secilit materialet i’u kanë dërguar me kohë, 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit. Përveç që është pikë e rendit të ditës, raporti i ZKA për vitin 2020 është edhe obligim ligjor ta paraqesim para Kuvendit të Komunës edhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit, por edhe para ZKA-së si dhe veprimet që kemi ndërmarrë dhe që do t’i ndërmarrim. Nuk do të doja të zgjatë më shumë, besoj që diskutimet rreth raportit, planit vjetor dhe planit të veprimit do t’i diskutojmë në seancën e Kuvendit që do të mbahet më 30.07.2021.

z.Mehmet Gashi, theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së i rekomandojmë Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës.

z.Florent Hasani, theksoi, edhe ne Grupi nga radhët e LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, po ashtu në emër të Grupit të PDK-së rekomandon që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në mbledhjen e Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

3. Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa dhe Gjoha Komunale

- Raporti nga diskutimi / debati publik

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF-së, theksoi, meqenëse sot i pranishëm nuk ka mundur të jet drejtori i DPZHE-së, më lejoni që të paraqes këtë pikë të rendit të ditës, edhe ky është një material i cili është dërguar me kohë, janë mbajtur diskutimet publike edhe pse nuk ka pasur të interesuar për këto diskutime publike e që ndoshta arsyeja ka qenë sepse është një pajtueshmëri absolute e njerëzve që taksat që janë për ushtrimin e veprimtarisë të hiqen. Normal që Rregullorja bazë është shumë më e gjerë për taksa dhe tarifa, gjoha, mirëpo bëhet fjalë vetëm për ndryshimin e rregullores në pjesën kur është për taksa për ushtrimin e veprimtarisë, prandaj është propozuar që kjo taksë të hiqet, prandaj kërkohet të votohet edhe nga ana e Kuvendit të Komunës si propozim rregullorë për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa tarifa dhe gjoha komunale.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë po duket se shefat e Grupeve të këshilltarëve u deklaruan që e përkrahin dhe që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, atëherë unë e hedh në votim.

Pas votimit njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozimit sipas kësaj pike të rendit të ditës.

4. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për vitin shkollorë 2020 – 2021

z.Avni Fetahu, Drejtor i DKA-së, theksoi, jam munduar që informatën ta përmbledh ashtu siç është me planin e punës, meqenëse është kërkuar informata për vitin shkollor 2020-2021 kam bërë një përmbledhje më të zgjeruar, kështu që jam i hapur për çdo gjë dhe për çdo diskutim të mundshëm.

znj.Arlinda Kadriu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e rekomandon për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së po ashtu rekomandon që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së rekomandon që informata në fjalë të diskutohet në mbledhjen e Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

5. Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

z.Fevzi Jetullahu, Drejtor i DSHPMSH-së, theksoi, në planin e punës së Kuvendit, për këtë muaj është paraparë që kjo informatë e DSHPMSH-së, prandaj e kemi përgatitur dhe është një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të Drejtorisë, e që po shpresoj t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

z.Mehmet Gashi, në emër të grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, theksoi, me qëllim të mos përsëritjes së gjërave sot dhe në mbledhjen e Kuvendit, jemi që t'i rekomandohet Kuvendit si pikë e rendit të ditës për diskutim.

z.Florent Hasani, theksoi, po ashtu edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit si pikë e rendit të ditës për diskutim.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së i rekomandohet Kuvendit për diskutim

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

6. Anulimi i Rregullores nr.prot.01-560/03-0045216/21 të datës 04.06.2021 për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

(Për arsye se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal e ka përcjellë shkresën e Zyrës së Kryeministrit sipas të cilës akti në fjalë nuk është në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës nr.06/L-084)

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nga Ministra përkatëse kërkohet se meqë akti në fjalë nuk parashihet me ligj nuk ka pasur nevojë të nxirret dhe në këtë rast janë tejkualuar kompetencat, atëherë kam kërkuar që ta anulojmë këtë rregullore me që i kemi tejkualuar kompetencat e Kuvendit pasi që gjithçka është e rregulluar me ligj.

Kemi informata dhe jemi interesuar edhe në aspektin ligjor, ne e dimë që disa komuna veç se kanë nxjerr dhe sot e tutje punojnë me këtë rregullore, por neve na është sjellë kështu siç keni mund ta lexoni, që ligji i rregullon të gjitha dhe nuk ka nevojë që komuna të nxjerr rregullore dhe ne duhet rekomanduar për ta shfuqizuar/anuluar. Ne e dimë që këtë iniciativë e kanë marr organet përkatëse komunale duke filluar prej zyrtarëve ligjor të Drejtorive, drejtoresha që ka qenë më herët e DSHMS-së deri tek drejtori tani i pranishëm i kësaj Drejtorie që kjo rregullore të kaloj dhe të miratohet në Kuvend.

Vlen të ceket se kjo rregullore është draftuar nga një organizatë jo qeveritare e cila në njëfarë forme e ka bërë unike për komunat, por ja që tani ka ardhur ky rekomandim dhe kjo kërkesë nga Ministria përkatëse dhe e kemi proceduar si pikë të rendit të ditës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, vendimet e Ministrisë ne i aplikojmë si Kuvend dhe ashtu parashihet me ligj, mirëpo me befasoi drejtori i DSHMS-së që nuk ishte këtu ta arsyetonte këtë çështje.

Pak më parë u përshëndetëm dhe biseduam me atë në hyrje. Është rregull se çdo material drejtori i Drejtorisë përkatëse e prezanton dhe informohet, ne gjithmonë kemi votuar për çështje që ndërlidhen me fëmijët, mirëpo meqë është vendim i Ministrisë, atëherë jam për atë që ta anulojnë, të mos nxjerrim diçka që nuk është në harmoni me ligjin.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, është mirë që si vërejtje nga ky komitet dhe nga kuvendi që gjithmonë që e përsërisim, po e ripërsëris edhe njëherë që të gjitha aktet të cilat përcjellën si pika të rendit të ditës që dërgohen në Kuvend, organet përkatëse të Komunës e sidomos të Ekzekutivit t'i sqarojnë mirë e mirë në aspektin ligjor, në mënyrë që edhe ne të mos i vendosim pikat e rendit të ditës të cilat nuk janë në harmoni me ligjin sepse pastaj po jemi në një situatë të keqe, së pari unë si Kryesues mos t'ju vendos juve në situata të tilla, por edhe ju vet si kuvendar për arsye se nuk është mirë sepse sikur po manipulohet Kuvendi me çështje dhe pika të rendit të ditës të cilat nuk kanë ligjshmëri.

Kështu që bëjë apel edhe njëherë nga këtu, ju lutem shumë e sidomos drejtorët e Drejtorive pikat e rendit të ditës, para se t'i sjellëni këtu konsultoni zyrën ligjore dhe të gjithë zyrtarët tjerë ligjor, qoftë edhe të nivelit qendrorë sepse fundja ata japin përgjigje kompetente për fushat e caktuara, në mënyrë që ne si Kuvend por edhe ju si Ekzekutiv të mos bëjmë shkelje ligjore dhe të mos merremi me çështje të tilla të cilat edhe përkundër që i votojmë de që nuk kemi pas të drejtë t'i votojmë.

z.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i LVV-së e rekomandojmë për shqyrtim në seancën e Kuvendit dhe ta shohim se si është kjo çështje, por meqë është vlerësim i Ministrisë jemi për ta anuluar këtë rregullore.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket anulimit të kësaj Rregullorje ne nuk kemi çka të diskutojmë sepse kjo duhet të anulohet dhe duhet të ketë kujdes për arsye se e njëjta është vlerësuar sikur me komisionin për ndarjen e shtëpive, dhe Ekzekutivi duhet ta ketë të çartë që institucionet qendrore në vazhdimësi brenda viteve bëjnë ndryshime dhe plotësim apo amandamentime të ligjeve dhe duhet në kontunitet të plotë të përcillen edhe miratimet e ligjet në Kuvendin e Kosovës, kështu që është e pa arsyeshme që nëse një Komunë e ka rregulluar një çështje të caktuar para 2-3 viteve të shikojmë njëjtë kur kemi plotësim ndryshim apo ligj të ri. Asnjë subjekt politik këtu nuk ka mundur të dal kundër një

Rregulloreje për mbrojtjen e fëmijëve për arsye se atë që e tha drejtori z.Fatlum Osmani, shembull po merret se këtu gjithçka po lidhet me partinë dhe me politikën, por nuk është ashtu sepse ne jemi të obliguar si asamble dhe si asamblistë dhe si Kuvend që të miratojmë vendime në interes të qytetarëve edhe këta muaj sa ka mbetur. Shumë pak e rëndësishme është kush është ulur këtu por këto propozim vendime për miratim në Kuvend vijnë nga ana e Kryetarit me propozim të Drejtorive përkatëse dhe tani nuk është diçka e jashtëzakonshme apo shumë e madhe që një drejtor një herë të mos mund ta përcjell.

Mua më inat po me vije sikurse që e tha edhe z.Mehmet Gashi se drejtori i DSHMS-së qëndron në korridor e nuk vije këtu të jap sqarime dhe arsyetime sepse ne gjithmonë gabojmë, nuk e them këtë vetëm pse është një drejtor i një subjekti tjetër, shembull të bëjmë një akuzë politike, mirëpo të qëndroj në korridor dhe të mos të merr veprim që t'i përcjellë ligjet dhe të qëndroj drejtor në një Drejtori.

Do të thotë, unë jam këtu, dhe nuk vie në mbledhje për të arsyetuar anulimin e kësaj rregulloreje për arsye se atëherë në kontinuitet po na shtynë me përcjell neve në mënyrë strikte ligjin dhe me dal me debatë këtu. Pastaj nëse do të dilnim në seancën e kaluar, cilido shef i grupit këtu apo asamblistë me thënë ne jemi kundër kësaj rregulloreje sepse nuk bënë kështu, të gjithë kohën nëpër Podujevë do të thuhej që grupi kësaj apo asaj partie është kundër miratimit të një rregulloreje për mbrojtjen e fëmijëve, kështu që ne nuk kemi çka diskutojmë që kjo pikë duhet apo jo t'i rekomandohet Kuvendit. Pastaj në fund po hynë edhe në performancë të Kuvendit të Komunës në tërësi e që nuk udhëhiqet nga ne por udhëhiqet nga një subjekt tjetër por që për performancën e tij po të vendos në vendin e fundit ose të parafundit si shkak i vendimeve jashtë ligjore, kështu që ne nuk kemi çfarë të diskutojmë për këtë por si pikë i rekomandojmë Kuvendit, mirëpo gjithçka çka ka të bëjë me pikën e Drejtorisë përkatëse është mirë të insistojmë që drejtorët të jenë këtu prezent, me përjashtim kur ndonjë drejtor është në udhëtim jashtë vendit, sepse ne jemi për të mbështetur diçka të mirë, jo për me akuzua kur është mirë e për me mbështet kur është keq, kështu që ne nuk kemi çfarë ta diskutojmë këtë pikë.

Kjo rregullore duhet të shfuqizohet / anulohet dhe duhet të respektohet ligji, këtë po e them sepse drejtori tjetër prej subjektit politikë të kaluar, më së shumti (ka gargarisë) ka ngritur zërin, për respektim të ligjit, akuzat më të mëdha janë bërë këtu që nuk po respektohet ligji, madje u diskutua edhe për fyerje, askush nuk ka fyer në Kosovë më shumë se ky subjekt, kështu që nuk kemi çfarë të diskutojmë për këtë çështje.

Ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit që kjo rregullore të shfuqizohet / anulohet, por është mirë që ju drejtorët prezent t'i tregoni drejtorit të DSHMS-së që të vijë në seancë të Kuvendit sepse ai duhet ta kuptoj këtë punë që nuk mundet të qëndroj drejtor duke sjell propozime në kundërshtim me ligjin.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ligjshmëria mbi të gjitha subjektet na obligon dhe na detyron, prandaj për të mos bërë gjëra të tilla, ju lutem të jemi më serioz dhe gjithmonë dhe çdoherë kur është në pyetje ligjshmëria ta respektojmë atë,

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës duke marrë për bazë shkresën e Ministrisë përkatëse rreth vlerësimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë.

Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10;45

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0061685/21

Podujevë,

28 korrik 2021

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi